

Tiranë, më datë 01.02.2018

**STATUT
I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

"JICA Studio Ligjore" Sh.p.k

Sot më datë 01.02.2018, unë e nënshkruara **Orkida Jica**, shtetase shqipëtare, e bija e Marashit dhe Vjollcës, lindur më datë 21.02.1988, në B.Curr, Tropojë dhe banuese në Tiranë, rruga "Rreshit Collaku", P.5, Shk.1, Ap.5, Njësia Bashkiake nr.10 mbajtëse e letërnjoftimit me nr.030585735, në përputhje me Ligjin Nr.9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" kam vendosur të krijoj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar "**JICA Studio Ligjore**" Sh.p.k, (më poshtë referuar si "Shoqëria"), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi.

**Kapitulli I
EMRI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA**

**Neni 1
Forma**

1. Shoqëria "**JICA Studio Ligjore**" Sh.p.k është themeluar në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe aktiviteti i saj rregullohet me anë të këtij Statuti.
2. Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

**Neni 2
Emri**

1. Emri i Shoqërisë është "**JICA Studio Ligjore**" Sh.p.k.

**Neni 3
Objekti**

Objekti i shoqërisë është:

1. Mbrojtje ligjore dhe përfaqësim i posaçëm dhe i përgjithshëm përparrë të gjitha shkallëve të procesit gjyqësor;
2. Këshillim, përfaqësim dhe shërbime ligjore në fushën e legjislacionit civil, penal (gjatë kohës së shoqërimit, ndalimit, arrestimit, gjatë procesit të hetimit, shqyrtimit gjyqësor), administrativ, të punës, doganor, bankar dhe atij fiskal;
3. Këshillim, përfaqësim dhe shërbime ligjore brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, si shoqëri apo në bashkëpunim me studio ligjore apo avokatë;
4. Konsulencë juridike në lidhje me formën ligjore të lindjes, ndryshimit, shuarjes së marrëdhënieve juridike të detyrimit apo atyre kontraktorë;
5. Këshillim, përfaqësim dhe shërbime ligjore për persona fizikë apo juridikë, shqipëtarë apo të huaj (klient) në çështjet civile, penale dhe administrative, në gjykatë, në arbitrazh dhe në organe të tjera të administratës publike;



6. Përpilim, hërtim, rishikim, kontrollim të dokumentacionit të nevojshëm dhe/ose depozitim në institucionet përkatëse dhe/ose ndjekje të procedurave ligjore, sipas çështjes konkrete të klientit (kërkesëpadi apo akte të tjera juridike, prokura për përfaqësim të subjekteve të interesuara, dokumente për regjistrim të shoqërive tregtare, dokumente të shoqërive tregtare të regjistruar si subjekte të së drejtës shqiptare apo të huaj, për ndryshimet e administratorëve, të ortakëve, ndryshimin e kapitalit, transferimin e kuotave, ndryshim statutit etj., kërkesa apo ankesa drejtar institucioneve përkatëse, akte që i nënshtronen veprimeve notariale)
7. Përpilim kontratasht të të gjitha llojeve, përfshirë këtu edhe kontratat aksesore si mjete të sigurimit për përbushjen e detyrimeve, si dhe të çdo dokumenti tjetër që sjell ose synon të sjellë pasoja juridike
8. Përgatitje të kërkesave drejtar Gjykatës së Apelit, Gjykatës Kushtetuese, Gjykatave Ndërkombëtare dhe çdo organizmi në të cilin aderon Republika e Shqipërisë;
9. Hartim të testamenteve në bazë të formave të njohura nga legjislacioni civil shqiptar.
10. Konsulencë juridike për çështjet e trashëgimisë ligjore dhe testamentare, përfaqësim në gjykatë për çeljen e trashëgimisë ligjore, kundërshtim të testamentit etj.
11. Ndjekje të procedurave të nevojshme për ekzekutimin e tituve ekzekutiv pranë Zyrave të Përmbarimit, deri në ekzekutimin e plotë të detyrimit;
12. Veprime të tjera të ndihmës juridike që parashikohen në ligj;

**Neni 4
Selia**

1. Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në: **Njësia Bashkiake nr.10, Rruga "Mujo Ulqinaku", Pallati Shushica, Nr.1, Kati I, Tiranë.**
2. Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i Vetëm) mund të vendosë të transferojë selinë e Shoqërisë në një vend tjetër, apo mund të vendosë hapjen e degëve dhe përfaqësive të Shoqërisë në çdo vend, brenda apo jashtë Republikës së Shqipërisë.

**Neni 5
Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë është e pa kufizuar.

**Kapitulli II
KAPITALI I SHOQERISE**

**Neni 6
Kapitali**

Kapitali i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë, i përbërë nga 1 (një) kuotë kapitali.

**Neni 7
Kuotat e kapitalit dhe zotërimi i tyre**

Kapitali është i përbërë nga 1 (një) kuotë kapitali, me vlerën nominale prej 100.000 (njëqind mijë) lekë.



Neni 8

Zmadhimi i kapitalit

1. Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i vetëm) mund të rrisë pa kufi kapitalin e Shoqërisë.
2. Administratori njofton për regjistrim, pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit, vendimin për zmadhimin e kapitalit. Vendimi publikohet edhe në faqen e internetit të Shoqërisë.
3. Zmadhimi i kapitalit bëhet efektiv në datën e regjistrimit të realizimit të tij, në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 9

Zmadhimi i kapitalit më aktive të Shoqërisë

1. Pas miratimit të bilancit të viti paraardhës, asambleja e përgjithshme mund të vendosë ta zmadhojë kapitalin e regjistruar, duke kaluar në kapitalin bazë rezervat e disponueshme dhe fitimet e pashpërndara.
2. Pjesa e rezervave, që shkon përtej 1/10 së kapitalit të regjistruar, si dhe fitimet e pashpërndara mund të kalohen në kapitalin fillestar.
3. Rezervat dhe fitimi i pashpërndarë nuk mund të kalohen në kapitalin bazë, nëse bilanci i viti paraardhës rezulton me humbje.

Neni 10

Zvogëlimi i kapitalit themeltar

1. Asambleja e përgjithshme (Ortaku i vetëm) mund të reduktojë kapitalin themeltar. Në çdo rast kapitali themeltar nuk mund të reduktohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.
2. Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qëndrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga administratorët. Ky vendim publikohet edhe në faqen e internetit të shoqërisë.

Neni 11

Transferimi i Kuotave

Transferimi i kuotave të kapitalit dhe e drejta e parablerjes. Kuotat e kapitalit mund t'u transferohen të tretëve tërësisht ose pjesërisht, vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Ortakut të vetëm).

Neni 12

Pasojat e kalimit të kuotave

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigen në mënyrë solidare ndaj Shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit.

Kapitulli III
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME, ADMINISTRIMI, KONTROLLI

Neni 13
Të drejtat dhe detyrimet

1. Asambleja e Përgjithshme (Ortaku i vetëm) është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për Shoqerinë për çështjet e mëposhtme
 - a. përcaktimin e politikave tregfare të Shoqërisë;
 - b. ndryshimet e statutit;
 - c. emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - d. emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - e. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - f. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - h. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - i. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j. përfaqësimin e Shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - k. riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
 - l. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m. çështje të tjera të parashikuara nga ligji.

Neni 14
Administrimi

1. Shoqëria administrohet nga Administratori. Funksion i cili do të kryhet nga ortaku i vetëm **Znj. Orkida Jica**, për një mandat 5 vjeçar, me të drejtë ripërtëritjeje.
2. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:
 - a. kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të Shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b. përfaqësojë Shoqerinë;
 - c. kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të Shoqërisë;
 - d. përgatisë dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpala asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e. krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e Shoqërisë;
 - f. kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të Shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;



- g. raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e Shoqërisë;
- h. kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Neni 15 **Detyrimi i besnikërisë dhe përgjegjësia**

Administratori detyrohet të kryejnë detyrat e tyre të përcaktuara në ligj ose në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të Shoqërisë në tërësi. Administratorët përgjigjen ndaj Shoqërisë për çdo veprim qe vjen në kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale.

Kapitulli IV **SHPËRNDARJA E FITIMIT**

Neni 16 **Shpërndarja e fitimeve**

1. Ortakët kanë të drejtë të ndajnë pjesën e fitimit të deklaruar në pasqyrat financiare të Shoqërisë.
2. Fitimi u shpërndahet ortakëve në raport me kuotat e zotëruara.

Kapitulli V **PRISHJA E SHOQËRISË**

Neni 17 **Shkaqet e prishjes së shoqërisë**

1. Shoqëria prishet:
 - a. kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
 - b. me vendim të Asamblesë së Përgjithshme (Ortakut të Vetëm);
 - c. me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - d. nëse nuk kryen veprimtari tregtare për dy vjet;
 - e. me vendim të gjykatës;

Neni 18 **Dispozita Kalimtare**

Ky Statut hartohet dhe nënshkruhet në gjuhën shqipe, në 4 kopje me vlerë të njëjtë ligjore.

Ortakët e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar

« JICA Studio Ligjore » Sh.p.k

Orkida JICA